

Akt Themelimi
i shoqërise me përgjegjësi të kufizuar “ IMMCONS ” SH.P.K

Mbështetur në Kushtetutën dhe Kodin Civil në fuqi të Republikës së Shqipërisë , në Ligjin Nr. 9901 datë 14.04.2008 , “ Për shoqëritë tregtare” dhe në Ligjin Nr.9723 , datë 03.05.2007 “Për Q.K.R” dhe formalitetet që duhen respektuar nga Shoqërite Tregtare , me vullnetin e tyre të lirë , të shprehur edhe në nënshkrimin e këtij akt-themelimi, sot më date 02 / 10 / 2024 une ortaku :

1. Arlind Limaj pajisur me karte identiteti Nr. I40517119N

Po krijojë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar “ IMMCONS ” SH.P.K me akt themelimi si vijon:

Neni 1

Formimi i shoqërisë

Formohet shoqëria tregtare private e quajtur “ IMMCONS ” SH.P.K . Shoqëria do të nënshtrohet legjislacionit shqiptar , ndërsa degët që mund të krijohen do të nënshtrohen legjislacionit ku do të ketë selinë dega. Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të këtij akti themelues dhe statutit të shoqërisë që do të miratohet nga ortakët themelues .

Neni 2

Selia e shoqërisë

- Selia e shoqërisë “ IMMCONS ” SH.P.K do të jetë: Vlore, Lagjja “Isa Boletini”, Rruga “Sulejman Delvina”, Objekt Nr.130", Kati 2, Prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Vlore,. Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon: av.arlindlimaj@gmail.com
- Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj , të hapë zyra përfaqësie , degë , të krijojë filiale si brenda ashtu dhe jashtë Republikës së Shqipërisë , vetëm me vendim të asamblesë së ortakëve.

Neni 3

Objektivi i veprimtarisë

Shoqëria do të zhvillojë veprimtaritë si vijojnë:

Ndërtim, konsulta dhe përfaqësim në gjykate, avokati dhe ndërmjetësim i pasurive të paluajteshme (shit-blerje etj.)

Neni 4

Kohëzgjatja e shoqërisë

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë me një afat të pacaktuar . Ajo mund shpërbehet në çdo kohë dhe për çfarëdo lloj shkak.

Neni 5

Kapitali i shoqërisë

Kapitali fillestar i shoqërisë private “ IMMCONS ” SH.P.K do të jetë 100 (njqind leke) dhe është i ndarë në aksione në përputhje me ligjin.

1. Ortaku themelues **Arlind Limaj** : Zotërues i një kuote që përbën 100% të kapitalit themelues të shoqërisë (100 njqind leke).



av.arlindlimaj@gmail.com

Neni 6
Drejtimi i shoqërisë

Shoqëria do të drejtohet nga administratori **Z. Arlind Limaj** me ID I40517119N i datelindjes 17.05.1984. Ai është përfaqësuesi i shoqërisë në marrëdhënie me të tretet dhe ka kompetenca të plota në drejtimin e saj. Cdo kontrate do të kryhet prej tij dhe në rast mungese nga një përfaqësues i pajisur me prokurë të posacme

Neni 7
Ortakët themelues kanë të drejte të emërojnë dhe administratorë të tjerë të vlerave materiale, kanë të drejtë të caktojnë financierë dhe likuidatorë për problemet e shoqërisë.

Neni 8
Konfliktet që mund të lindin do të zgjidhen në zbatim të legjislacionit Shqiptar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë .

Neni 9
Shoqëria ka vulën e saj me madhësi të zakonshme , me tekstin rreth saj .

Neni 10
Shoqëria deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave të statutit dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe vecanerisht të Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 “Për Krijimin e Shoqërive Tregtare” , si dhe duke zbatuar ligjet ndërkombetare dhe të vendit si dhe rregullave që zbatohen për biznesin që kryen kjo shoqëri .

Neni 11
Akti i themelimit u përpilua në 2 kopje , për t’ju shpermdare organeve kompetente dhe një kopje do të mbetet në dokumentacionin bazë të shoqërisë private “ **IMMCONS** ” **SH.P.K**

Akti i themelimit nënshkruhet rregullisht nga ortaku I vetem .

Ortaku i vetem i “ **IMMCONS** ” **SH.P.K**
Arlind Limaj



av.arlindlimaj@gmail.com